



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
BORDI

VENDIM

Nr. 282, Datë 07.11.2022

MBI

ZGJATJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME FILLIMIN E
PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË “DOSKU –
ENERGY” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 67 dhe 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.11.2022, mbasi shqyrtoi Relacionin me nr 1885/3-1 prot., datë 07.11.2022 të Drejtorive Teknike, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Këshilltares së Bordit “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s lidhur me fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “DOSKU-ENERGY” sh.p.k.”,

Konstatoi se:

- Në adresën e postës elektronike të ERE (e-mail: datë 7.11.2022), protokolluar në ERE më datë 7.11.2022, me nr. 207/36 prot., përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “DOSKU-ENERGY” sh.p.k., ka paraqitur kërkesën për shtyrjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s lidhur me procedurën e nisur me vendimin e bordit të ERE nr. 188, datë 21.07.2022, për heqjen e licencës së shoqërisë “DOSKU – ENERGY” sh.p.k.
- Shoqëria në kërkesën e saj pretendon se: *Administrata e ERE do vinte në dispozicion raportin paraprak me gjetjet përkatëse, në mënyrë që shoqëria Dosku - Energy sh.p.k., të kishte mundësi të njihej me to, të ushtronte të drejtën e mbrojtjes, të paraqitjes së provave dhe të dokumentacionit të nevojshëm, nëse do të ishte e nevojshme.*
- Shoqëria “DOSKU ENERGY” sh.p.k. në mbledhjen e datës 06.10.2022 dhe në vijim me e-mail, në datën 11.10.2022, ka kërkuar një kopje të të gjitha provave të paraqitura në ERE nga “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k. ERE me shkresën nr. 207/33 prot., datë 28.10.2022, i ka dërguar kësaj shoqërie dokumentacionin e kërkuar.
- Ne nenin 67 të “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar se: *organi publik, që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme, kur gjykohet se mos marrja e masave të caktuara do të shkaktonte një dëm të rëndë e të pariparueshëm mbi interesin publik, apo të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve.*

Gjithashtu në nenin 87, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet se përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik,

njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t'u dëgjuar.

- Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 67 dhe nenit 87 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vlerësohet zgjatja e vendimmarrjes së bordit të ERE lidhur me procedurën e nisur me vendimin nr. 188, datë 21.07.2022, në lidhje me fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “DOSKU - ENERGY” sh.p.k., deri në 30 ditë nga marrja dijani e këtij vendimi.
- Pretendimi i shoqërisë që administrata e ERE-s duhet t'i vendoste në dispozicion “raportin paraprak me gjetjet përkatëse”, në mënyrë që shoqëria “DOSKU-ENERGY” sh.p.k., të kishte mundësi të njihej dhe të ushtronte të drejtën për t'u mbrojtur, është i paqartë, pasi ERE nuk disponon dokumentacion me titull apo përmbajtjen e sipërcituar, ndaj vlerësohet që brenda datës 10.11.2022, shoqëria “DOSKU-ENERGY” sh.p.k. të saktësojë objektin e kërkesës së saj të datës 07.11.2022 në lidhje me administrimin e dokumentacionit të kërkuar nga ana e saj.
- Me qëllim që t'i mundësohet ushtrimi i të drejtave që burojnë nga neni 87 i KPA-së , vlerësohet t'i lihet afat shoqërisë që brenda datës 18.11.2022, të paraqesë në ERE komente apo vlerësime të mundshme mbi dokumentacionin e dërguar me shkresën e ERE-s nr. 207/33 prot., datë 28.10.2022.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 ditë vendimmarrjen e bordit të ERE lidhur me fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “DOSKU ENERGY” sh.p.k.
2. Brenda datës 10.11.2022, shoqëria “DOSKU-ENERGY” sh.p.k. të saktësojë objektin e kërkesës e saj të datës 07.11.2022, në lidhje me administrimin e dokumentacionit të kërkuar nga ana e saj.
3. Brenda datës 18.11.2022 shoqëria “DOSKU ENERGY” sh.p.k. të parashtojë në ERE komente apo vlerësime mbi provat e administruara, si dhe çdo argument që i shërben ushtrimit të së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur për aq sa është administruar nga shoqëria me shkresën e ERE-s nr. 207/33 prot., datë 28.10.2022.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “DOSKU-ENERGY” sh.p.k., shoqërinë “C&S CONSTRUCTION ENERGY” sh.p.k., dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI